



ËSHTË ARRIT MARRËVESHJA MES DAP-it DHE O.S SOLIDARITETI, PUNONJËSIT DO TË MARRIN PAGË MË TË LARTË PËR MUAJIN KORRIK

Drejtoresha e DAP-it, Sanja Lukarevska në pres konferencën e sotme për media, së bashku me pajtuesin dhe arbitrin e licencuar në kontestet e punës, MSc Ilija Manasiev, dhe kryetarin e organizatës sindikale të DAP-it "Solidariteti" Vase Nedanoski, e informuan publikun se procedura për përfundimin e lidhjes së Marrëveshjes së re të punësimit mes përfaqësuesit të Sinikatës së DAP-it dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike- si punëdhënës, e cila filloi rreth 6 muaj më parë, përfundoi me sukses me nënshkrimin e një Kontrate Kolektive, me të cilën u mor pëlqimi i Ministrisë së Financave.

Drejtoresha Lukarevska falënderoi ekipet që punuan me përkushtim në muajt e fundit dhe ishin pjesë e procesit të pajtimit.

“Për ne kjo do të thotë jo vetëm të drejta më të mëdha, por edhe detyrime më të mëdha për zyrtarët tatimorë, sidomos tani me programin e ri të reformës, që kërkon angazhim më të madh dhe investim më të madh nga të gjithë për ta realizuar atë. Rritjen e pagave e shoh si një motiv plus për një efikasitet më të madh si nëpunës tatimor. Rezultatet tona më të mira do të kontribuojnë gjithashtu në rezultate më të mira në funksionimin social. Më vjen mirë që jemi shembull i mirë se si duhet të funksionojë sindikata me punëdhënës”, tha Lukarevska.

Arbitri në këtë proces, Ilija Manasiev, sqaroi se gjatë gjithë procesit dhe procedurës kemi punuar në grup, dhe gjithë procedurën e ka udhëhequr punëdhënësi, i përfaqësuar nga drejtoresha Lukarevska dhe kryetari i Solidaritetit Vase Nedanovski, të cilët për një kohë të shkurtër kanë formuar këshill kualitativ për pajtim.

Për sa i përket aspektit të mosmarrëveshjes, ky është një nga rastet më të mëdha të marrëdhënieve të punës, e cila është zgjidhur përmes pajtimit.

Për këtë mosmarrëveshje ka pasur interes edhe jashtë kufijve të Maqedonisë. Institucione të shumta që janë relevante në fushën e punës, Agjencitë e pajtimit ndërkombëtare si dhe ato përreth, të gjithë e ndoqën nga afër mosmarrëveshjen dhe supozoj se ky do të jetë shembull i mirë në praktikë edhe në shtetet tjera ku do të ketë mosmarrëveshje të këtij lloji, i tha Ilija Manasiev.

Kryetari i O.S “Solidariteti”, Vase Nedanoski tha se ky sukses është sukses i gjithë ekipit që ka punuar në këtë proces.

“Dua të shpreh kënaqësinë time për veprimin ligjor të të gjithë atyre që janë kompetentë dhe të përfshirë në këtë proces. Është nënshkruar Marrëveshja Kolektive me sindikatën përfaqësuese “Solidariteti”. Në përputhje me ligjin, u rregullua përmbajtja e Kontratës Kolektive, me të cilën pagat e punonjësve të Drejtorisë së të Ardhurave Publike u rritën për 30%.– theksoi kryetari i “Solidaritetit” Vase Nedanovski.

Të pranishmit sqaruan se punonjësit e Drejtorisë së të Ardhurave Publike do ta marrin pagën e muajit Korrik me rritje.

